



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 722/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi kryesues, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevcu anëtar, duke vendosur lidhur me apelin e Subjektit Politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK)-dega në Ferizaj, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. Protokoli 2858/2021 të datës 28.10.2021, për shkak të mospërputhjes së votave të kandidatit për kryetar Komune –Ferizaj, për Zgjedhjet Lokale, të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 31.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.722/2021 i datës 29.10.2021, i paraqitur nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) - dega në Ferizaj, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. Protokoli 2858/2021 të datës 28.10.2021, për shkak të mospërputhjes së votave të kandidatit për kryetar Komune - Ferizaj, për Zgjedhjet Lokale, të datës 17.10.2021.

A r s y e t i m

Me datë 29.10.2021, PZAP ka pranuar apelin Anr.722/2021, nga përfaqësuesi i Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK)-dega në Ferizaj, me të cilin pretendon se duke u bazuar në rezultatin përfundimtar të publikuar nga KQZ-së, ka mospërputhje të rezultatit preliminar, votave me kusht dhe me postë në rezultatin përfundimtar për kandidatin për kryetar Komune në Ferizaj, Agim Aliu nga radhët e Subjektit Politik PDK. Parashtruesi i apelit pretendon se në tabelën e votave të rezultatit preliminar të kandidatit për kryetar të Komunës së Ferizajit, Agim Aliu nga radhët e Subjektit Politik PDK ka fituar me 30.441 vota të rregullta, në publikimin e votave me kusht rezultojnë 477 vota , me postë 81 vota dhe në bazë të këtyre dëshmime rezultati për kandidatin në fjalë duhet të ishte 30.999 vota. Më tutje në apel theksohet se në rezultatin preliminar të KQZ-së publikohen 30.627 vota, kurse nga publikimet e KQZ-së të sqaruara më lartë dalin 30.999 vota, ku sipas parashtruesit të apelit dëmi eventual që mund të shkaktohet rezulton në 372 vota më pak për kandidatin e tyre për Kryetar të Komunës së Ferizajit, Agim Veliu. Si dëshmi apelit ia ka bashkangjitur

publikimet e rezultateve nga faqja zyrtare e KQZ-së, andaj ne ankesë kërkon që PZAP-i ta aprovoj apeli në fjalë.

Përgjigje në apel ka paraqitur KQZ, me të cilën thekson se pas shqyrtimit të apelit dhe pretendimeve të palëve ankuese, në lidhje me kërkesën në fjalë njofton se Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), ka përfunduar procesin punës, si dhe futjen e të dhënave, skanimin e materialeve zgjedhore, verifikimin, hetimin e Formularëve e Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve, Formularët e Rezultateve të Kandidatëve FRK, procese këto që mundësojnë evitimin e çdo gabimi teknikë dhe jo relevantë. Më tutje në përgjigjen e KQZ-së theksohet se rezultatet preliminare nuk mund të konsiderohen përfundimtare, sepse gjendja e tyre ndryshon varësisht nga rezultati i progresit të procedimit të të dhënave nga secili vendvotim në QNR, siç theksojnë se gjendja e numrit të votave mund të ndryshoj nga momenti i fillimit të procesimit të materialeve e deri në përfundimin e futjes së të dhënave për të gjitha vendvotimet. Në vazhdim thuhet se kjo gjendje mund të ndryshoj sepse, rezultateve nga vendvotimet i shtohen edhe rezultatet e votave me kusht dhe votat përmes postes.

Paneli, pasi që shqyrtoj apelin vlerësoi se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtuesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin. Në rastin konkret, sipas përgjigjes në apel nga ana e KQZ-së rezulton fakti se pretendimet e apellesit janë të pa bazuara, sepse rezultati preliminar nuk konsiderohet përfundimtar dhe gjendja e tyre ndryshon varësisht nga rezultati i progresit të procedimit të të dhënave nga secili vendvotim në QNR.

Në rastin konkret ankuesi nuk ka paraqitur asnjë provë tjetër pos kopjes së rezultatit preliminar nga faqja e KQZ-së, dhe kopjen e rezultatit përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja, duke mos bashkangjitur as Formularin i Përputhjes së Rezultateve, Formularin e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularin e Rezultateve të Dengut (FRD) (formular me të cilën regjistrohen votat me kusht dhe votat jashtë Kosove). Andaj në mungesë të provave paneli vendosi që apeli i paraqitur nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), lidhur

me rezultatin e kandidatit të tyre për kryetar Komune të Ferizajt, Agim Aliu, të refuzohet si e pabazuar. PZAP vlerëson se rezultati preliminar është proces i numërimit të votave dhe rrjedhimisht ky rezultat përderisa është proces, mundë edhe të ndryshoi. Megjithatë si i tillë nuk cenon të drejtën e kandidatit, pasi që nuk ka një rezultat përfundimtar të votave, dhe vetëm rezultati përfundimtar i shpallur mund të jetë i atakueshem me apel. Në rastin konkret për rezultatin përfundimtar, kandidati nuk ka paraqitur asnjë provë për të provuar se i është cenuar e drejta lidhur me numrin e votave që janë shpallur në rezultatin përfundimtar.

Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka mundësi të votave për kandidatin për Kryetar Komune të Ferizajt, Agim Aliu nga radhët e subjektit politik PDK, prandaj një pretendim i tillë refuzohet si i pa bazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 722/2021 më datën 31.10.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.